



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pyltqarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 27.09.2024, merr:

### V E N D I M

#### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

##### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0064143/24 të datës 23.09.2024, për përkrahje në projektin përkrahje me furnizim me pajisje për bletë ngritët komisioni në këtë përbërje:

<b>Rilind Babatinca</b> , zyrtar për zhvillim - DPZHE	kryesues
<b>Xhevrie Beqiri</b> , zyrtare për kthim të qëndrueshëm - ZKK	anëtare
<b>Alban Shabani</b> , zyrtar për evidentimin e pronës se paluajtshme - DBF	anëtar

##### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Anëtarëve të komisionit  
Drejtorisë së Bujqësisë Pyltqarisë dhe Zhvillimit Rural.  
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0065892/24  
Podujevë, datë, 01.10.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 3 paragrafi 3, nenin 11 paragrafi 2, dhe nenin 27 paragrafi 1.7 të Rregullores komunale për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot. 02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0063588/24 të datës 18.09.2024, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit përmes Kërkesës nr.prot. 02-400/04-0064031/24 të datës 23.09.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Latif Mehmeti**, nga Podujeva, për përkrahje në botimin e dy librave “Gjenocidi serb në Komunën e Podujevës”, dhe “Rrëfimet e 88 të mbijetuarave nga krimet serbe në luftën e vitit 1998/1999”, me qëllim të dokumentimit të krimeve serbe në Llap, mbështetet me mjete financiare në shumë 2000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorive përkatëse.*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Latif Mehmeti (njoftohet përmes DKRS-së).*

Nr.Prot. 02-400/01-0065900/24  
Podujevë, datë, 01. 10. 2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, ë funksion të zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2025, nxjerr:

### V E N D I M PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-016/01-0072756/23 DATË 04.10.2023

#### Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. prot. 02-016/01-0072756/23, datë 04.10.2023 për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2024, dhe atë:

-Në vend të znj.Majlinda Gashi, në cilësinë e anëtares së Komisionit caktohet **znj.Vahide Veseli**, zyrtare në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa

- **z. Arbër Sfishta**, zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit caktohet anëtar në kuadër të Komisionit.

#### Neni 2

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr. prot. 02-016/01-0072756/23, datë 04.10.2023 për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2024.


#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:  
Anëtarëve të Komisionit  
ASK-së  
QSHQ/ Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0064354/24  
Podujevë, datë: 15.10.2024

Kryetari i Komunës  
Shepjetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**z. Ismet Kadriu**, udhëheqës sektorit të urbanizmit në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

I Autorizuari  
Drejtoria e Inspeksionit  
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva

Nr. prot. 02-016101-006690124  
Podujevë, datë: 07.10.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**z. Veton Aliu**, inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

I Autorizuari  
Drejtorja e Inspeksionit  
Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva

Nr. prot. 02-016/01-0066900/24  
Podujevë, datë: 07.10.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 3.3, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01 -0071612/23, të datës 27.09.2023, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit "Sera Bujqësore 500m<sup>2</sup>", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0034088/24 të datës 27.05.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0060365/24, të datës 04.09.2024, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 5 fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për projektin "Sera Bujqësore 500m<sup>2</sup>".

2. Mbështetja e fermerëve bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin "Sera Bujqësore 500m<sup>2</sup>", përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

#### Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

#### Neni 3

Lista e aplikuesve të për zgjedhur për implementimin e projektit: "Sera Bujqësore 500m<sup>2</sup>", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria së Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/03-0067778/24  
Podujevë, datë 10.10.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0067537/24, të datës 09.10.2024, merr:

### **V E N D I M** **PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

#### **Neni 1**

[Redacted] nga fshati Obrancë, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 300.00€.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të z. [Redacted]

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit*


*z. Sabit Halili (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/03-0068611/24  
Podujevë, datë, 16.10.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0066343/24, të datës 03.10.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

[Redacted] nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 2000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të [Redacted]

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit*

*z. Gazmend Islami (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/03-0068612/24  
Podujevë, datë, 16.10.2024







**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026, në implementim të projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0037290/24 të datës 07.06.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0046814/24 të datës 18.07.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0050312/24 të datës 01.08.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0059692/24 të datës 02.09.2024 në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0043346/24 të datës 04.07.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-016-0051363/24 të datës 05.08.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 22,280.00€, nga e cila 15,596.00€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 6,684.00€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me mekanizëm bujqësor", përkatësisht për 8 fermer përfitues, dhe atë për;

- Mbjellëse të misrit mekanike me plehërim,.....2 fermer përfitues
- Makinë për shtrirjen e folisë plastike, sistemit pikë pikë dhe mbjelljen e fidanëve dhe perimeve.....2 fermer përfitues
- Frezë për motokultivator 12HP,.....4 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor".

### **Neni 2**

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

### **Neni 3**

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

### **Neni 4**

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0069928/24  
Podujevë, datë, 22.10.2024

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione merr;

### **VENDIM**

#### **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 15,650.00€, ndihmë për gjashtëdhjetë (60) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale për muajt gusht, shtator, tetor, 2024, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

##### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### **Neni 3**

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

##### **Neni 4**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

##### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### **Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0069930/24  
Podujevë, datë 22.10.2024

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 Për Agjencinë Për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, Vendimit 1476/23 të datës 26.07.2023, Për Miratimin e Metodologjisë për Planet e Integritetit merr:

### V E N D I M PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2024-2026

- I. Miratohet Plan i Integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me vendimin nr.prot.02-20/04-0061134/24, i datës 06.09.2024.
- II. z.Nexhat Tovërlani, udhëheqës për komunikim me publikun, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

#### Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, titullari i institucionit nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit të hartuar nga grupi punues i caktuar me vendimin nr.prot.02-20/04-0061134/24, të datës 06.09.2024, të theksuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

z.Nexhat Tovërlani, udhëheqës për komunikim me publikun sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

U dërgohet;

Anëtarëve të grupit punues

Të caktuarit

Agjencisë Për Parandalimin e Korrupsionit

QSHQ/Arkivit


Nr. Prot. 02-016/01-0070131/24  
Podujevë, datë, 23.10.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**



**PLANI PËR INTEGRITET**  
**PËR**  
**KOMUNËN E PODUJEVËS**  
**2024 – 2026**

Përmbajtje:

<b>1. Deklarata e Integritetit .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Hyrja .....</b>	<b>5</b>
<b>3. PLANI PËR INTEGRITET.....</b>	<b>5</b>
<b>4. Parimet e menaxhimit të Integritetit .....</b>	<b>8</b>
<b>4.1 Lidershipi.....</b>	<b>8</b>
<b>4.2 Përfshirja e personelit .....</b>	<b>8</b>
<b>4.3 Qasja sistemore .....</b>	<b>8</b>
<b>5. Objektivat e Planit të Integritetit .....</b>	<b>8</b>
<b>6. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit .....</b>	<b>9</b>
<b>6.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit .....</b>	<b>9</b>
<b>6.2 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut .....</b>	<b>10</b>
<b>6.1.1 Matrica vlerësimit të rrezikut .....</b>	<b>10</b>
<b>6.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut .....</b>	<b>11</b>
<b>7. Monitorimit i zbatimit të planit të Integritetit dhe raportimi .....</b>	<b>11</b>
<b>8. Fushat e rrezikut .....</b>	<b>13</b>
<b>8.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut.....</b>	<b>13</b>
<b>8.2 Fushat specifike të rrezikut .....</b>	<b>13</b>

## 1. Deklarata e Integritetit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklaratë gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Podujevës dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në republikën e Kosovës.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio – ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë pa dallim.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që komuna të përmbushë objektivat dhe synimet e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet e përcaktuara nga Ligji nr.08/L-017 Për Agjencinë Për parandalimin e Korrupsionit si dhe Vendimit 1476/23 të datës 26.07.2023, Për Miratimin e Metodologjisë për Planet e Integritetit.

Konsiderojmë se profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikon që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Plani jonë i Integritetit konfirmon që ne me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e organizatës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parime dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme të përcaktojmë ekspozimet e mundshëm të organeve të administratës komunale, kushteve të tyre organizative, proceseve dhe punonjësve, ndaj korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në punën e organeve të administratës komunale.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i riskut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e riskut ndaj integritetit në kulturën e komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja jonë me vullnet të lirë, si individë, si Komunë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi kodit të etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojmë në pajtim me ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi, normave juridike, kulturës, besimit dhe standardeve etike të rregulluara me ligj dhe sipas vlerave dhe parimeve të shoqërisë demokratike.

Ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në krijimin e një kulture organizative të punës, respektim të kodit etik të mirësjelljes, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e institucioneve me theks në nivelin lokal dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

Data: 23. 10. 2024



Kryetari i Komunës



## 2. Hyrja

Në bazë të nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 Për Agjencinë Për parandalimin e Korrupsionit, Vendimit 1476/23 të datës 26.07.2023, Për Miratimin e Metodologjisë për Planet e Integritetit, Komuna e Podujevës ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmerisë së një Komune dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Podujevës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah klienti. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## 3. PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik, që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm parandalues për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek risku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

### **Plani i integritetit mundëson:**

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizate individuale;
- Vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale; dhe
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

### **Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:**

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;

- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponoheshes kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsion përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpronësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij Plani, komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara dhe kënaqësi të shtuar të palëve të interesuara. Gjithashtu, komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të përmirësuara për qytetarët dhe rritje të kënaqshmerisë nga ana e palëve të interesuara.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të organizatës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e stafit.

Së fundmi, ne besojmë se duke implementuar këtë Plan, Komuna e Podujevës është në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbime më të përmirësuara për publikun dhe rritje të kënaqshmerisë nga ana e palëve të interesit. Ne e konsiderojmë këtë Plan si fillimin e një rrugëtimi afatgjatë dhe që synon një sistem menaxhimi integriteti funksional.

Në vijim të Strategjisë Kosovare Anti-Korrupsion dhe të Planit të Veprimit, ku Plani i Integritetit do të implementohet për gjatë viteve 2024-2026, në përputhje me ciklin e radhës të planifikimit strategjik anti-korrupsion.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Podujevës e ka bërë në periudhën 2024-2026. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të organizatës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

**Për të arritur këtë, Komuna ka ndërmarrë veprimet në vijim:**

- Ka rishikuar kornizën relevante të strategjive rregullative dhe operative, d.m.th. Planin për zhvillim institucional, Strategjinë për qeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe aktet tjera nënligjore etj;
- Ka analizuar të dhëna nga performanca e integritetit, monitorimi dhe implementimi;
- Ka analizuar kënaqshmërinë dhe perceptimin e klientëve për korrupsion në qeverisjen lokale përmes anketimeve dhe raporteve të kërkuara nga organizata ndërkombëtare;
- Ka zhvilluar një mjet referues për vetëvlerësimin e organizatës që të ofrojë informacion dhe të dhëna të dobishme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në Komunë, të analizuar në bazë të rezultateve, fushave të perceptuara të riskut dhe fushave të identifikuara për përmirësim (është zhvilluar korniza për vetëvlerësimin e integritetit të organizatës);
- Ka përdorur seanca pune për diskutim të ideve, intervista të strukturara me personel kryesor dhe konsultime me stafin si teknika për të identifikuar dhe vlerësuar risqet ndaj integritetit dhe për të renditur masat parandaluese është rishikuar lista e rreziqeve dhe lista e vetëvlerësimit.
- Ka përdorur dokumente/udhëzues të ndërlidhur me zhvillimin e integritetit nga UNDP, Kompilacione të Praktikave më të Mira të Integritetit, doracakë të TI, standardet e riskut ISO 31000 dhe FERMA, Specifikimin BS 10500 për sistemin e menaxhimit të anti-mitos; Standartin australian/zelandez për anti-korrupsion AS 8001-2008; Udhëzuesin ISO 26000 për përgjegjësi sociale; Parimet e Biznesit të Transparency International për të Luftuar Miton; kërkesat për sistemin e menaxhimit

të cilësisë ISO 9001 dhe Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001, si referencë për të mbështetur masat e propozuara.

#### **4. Parimet e menaxhimit të Integritetit**

##### **4.1 Lidershipi**

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshëm të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

##### **4.2 Përfshirja e personelit**

Pjesëmarrja e secilit zyrtarë është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi në mesë tyre janë efektiv dhe të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

##### **4.3 Qasja sistemore**

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komuna e Podujevës që t'i kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre dhe një gjë e tillë arrihet brenda për brenda grupit punues në komunën e Podujevës .

#### **5. Objektivat e Planit të Integritetit**

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme gjithëpërfshirëse ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Krijimi i vetëdijes së qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimin e sundimit të ligjit.

## 6. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cënueshmërive të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cënueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cënueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Të gjithë të punësuarit kanë mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

## 6. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 06.09.2024 ka marrë vendim nr.prot.02-020/04-0061134/24 për ngritjen e grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit.

Grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit më datë 04.10.2024, ka mbajtur punëtori gjatë asaj punëtorie të gjitha propozimet e anëtarëve të grupit janë të përfshira në tekst të Planit të Integritetit.

### 6.1 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

#### 6.1.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e komunës në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

<b>Pasojë /Ndikimi</b>	<b>Madhor</b>	10																			
		9																			
		8																			
	<b>Mesatar</b>	7																			
		6																			

	Vogël	5									
		4									
		3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar			Lartë			
		Probabiliteti/Gjasat									

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

### 6.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## 7. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në

projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

**7.1 Grupi punues-** emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike të punonjësve;
- koordinimin dhe pjesëmarrjen në përgatitjen e programit për zhvillimin e planit të integritetit
- mbajtjen e Planit të Integritetit në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar dhe luftimi në mënyrë proaktive të kërcënimeve ndaj integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike
- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur PI;
- mbikëqyrjen e zbatimit të masave për përmirësimin e integritetit;



- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit.
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit.

Menaxheri i Integritetit raporton te Kryetari i Komunës çdo tre muaj mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe një herë në vit në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

**7.2 Menaxheri i Integritetit** - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- përgatitë programin për hartimin e Planit të Integritetit;
- mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit-
- përgatitë dhe shpërndan pyetësozin si dhe zhvillon intervistat me punëtorët me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit
- harton draftin e Planit të Integritetit dhe prezanton te punëtorët për komente
- finalizon draftin e Planit të Integritetit dhe e dërgon për miratim te Kryetari i Komunës.

Koordinatori dhe Grupi Punues gjithashtu mbështetin Menaxherin e Integritetit në monitorim dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit.

## 8. Fushat e rrezikut

### 8.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve.

### 8.2 Fushat specifike të rrezikut

Fushat e veçanta të rrezikut janë:

- Auditimi i Brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Zhvillimi ekonomik lokal;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi Publik;
- Shëndetësia dhe mirëqena sociale;
- Shërbimet publike dhe Licencimi i shërbimeve;
- Komunikimi me palët e jashtme të interesit;
- Prona, kadastri dhe gjeodezia;
- Kultura, rinia dhe sporti;
- Bujqësia ,pylltaria dhe zhvillimi rural;

**PLANI INTEGRITETIT**

**FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT**

Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
		Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	rrezikut i Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
<b>N</b>	<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Përshkrimi i Rrezikut</b>						
<b>1.</b>	<b>DREJTIMI DHE MENAXHIMI</b>	Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor.	5	8	40	Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës	Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, drejtuesit e organeve që janë në vartësi të Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës	Implementimi brenda 12 muajve
		Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme	3	5	15	Përditësimi i informatave në Eëfaqen e Komunës, me qëllim informimin e qytetarëve dhe të tjerëve për aktivitetet e Komunës	Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, drejtuesit e organeve që janë në vartësi të Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës	Në vazhdimësi
						Informimi në vazhdimësi i qytetarëve me procedurat e hartimit dhe miratimit të akteve me interes publik, me qëllim	Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, drejtuesit e organeve që janë në vartësi të Komunës dhe drejtorët e drejtorive të	Në vazhdimësi







						aktiviteteve të tjera të paligjshme.	Njësia e Burimeve Njerëzore dhe të gjithë zyrtarët publikë	Në 6-mujorin e parë të vitit 2025	
				7	8	56	Miratimi i një akti të brendshëm për regjistrimin e raportimeve të korrupsionit brenda institucionit dhe trajtimin e tyre, si dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesve.	Kryetari i Komunes, Kryesuesi i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive si dhe zyrtari përgjegjës	
				6	8	48	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të komunës	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit; Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit;	Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e drejtorive
<b>3. PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE</b>	Trajtimi jo adekuat i raporteve të paraqitura nga sinjalizuesi dhe mos mbrojtja e identitetit dhe të drejtave të sinjalizuesve.	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.	Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent	5	9	45	Hartimi dhe miratimi i raporteve dhe planit të shpenzimeve	Kryetari i Komunës dhe drejtorja për Financa dhe Buxhet	Pas aprovimit të buxhetit vjetor
							Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Drejtorja për Financa dhe Buxhet	Çdo muaj
							Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb	Zyra për Informim	





		të kompjuterizuara				të kompjuterizuara			
Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit		3	3	9		Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar		Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës	Dhjetor 2025
<b>Veprimi ndaj rrezikut</b>									
<b>Regjistrimi i rrezikut</b>									
N	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit			
1.	<b>AUDITIMI I BRENDSHËM</b>	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të komunës	Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevojë. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e Auditimit	Çdo fundvit			
		Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve					Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive	1-muaj pas marrjes së raportit nga auditimi i brendshëm.	

								Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Drejtorët e drejtorive	Çdo 3-muaj
	Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së AB, Komitetit të Auditimit dhe Kryetarit		3	8	24			Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njesisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale.	Kryetari i Komunës, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit	Në vazhdimësi
<b>2. PROKURIMI PUBLIK</b>	Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të komunës	7	9	63			Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë	Njësia e prokurimit dhe drejtorët e drejtorive përkatëse	Në vazhdimësi
	Mos transparencë dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme e prokurimit publik		5	10	50			Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	12-muaj
								Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës	Njësia e prokurimit	Pas miratimit të planit të prokurimit
								Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale	Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm.	Çdo 3-mujor
								Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të	Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit	Në vazhdimësi

		qarta të kontaktit							
<b>3.</b>	<b>ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL</b>	Menaxhimi i efikasitetit të kontratave/projekteve	8	9	72	Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit		Njësia e Prokurimit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorë të drejtorive përkatëse	Çdo vit
		Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal	4	9	36	Hartimi, rishikimi, përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës		Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Implementohe t brenda viteve 2024/2025
		Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente.	5	7	35	Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal.	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Financa dhe buxhet	Implementohe t brenda viteve 2024/2025
		Kritere jo të qarta dhe transparencë e pamjaftueshme në ndarjen e subvencioneve	3	6	18	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive		Kryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive Përkatëse	Dhjetor 2025

			nënligjore dhe brendshme të komunës	3	8	24	Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Financa	Në vazhdimësi
	Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal		3	3	24	Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal	Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Financa dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
	Mbikëqyrja jo efektive mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal		3	8	24	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal		Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Financa	
<b>4. PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL</b>	Mangësi në rregullativën e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban dhe rural	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës dhe	6	10	60	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban	Implementime t brenda viteve 2024/2025
	Zbatimi i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen		5	10	50	Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullativës së brendshme		Drejtoria për Planifikim Urban dhe Njësia e	Çdo 3-muaj

<b>5. STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI</b>	me fushën e planifikimit urban dhe rural	planet gjenerale urbane	4	9	36	Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Burimeve Njerëzore
	Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural		5	9	45	Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Planifikim Urban
	Mbikëqyrja jo efektive mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural		7	9	63	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Inspektion
	Mungesa e stafit konsistente mbi ndërtimet (vendpunishtet)	Ligjet, aktet nënligjore;	4	10	40	Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje.	Drejtoria për Planifikim Urban
	Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve	aktet e brendshme të komunës dhe planet gjenerale urbane				Të sigurohet personeli adekuat profesional për planifikim urban dhe rural	Implementohe t brenda 6-9 muajve
					Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Çdo vit

<b>6.</b>	<b>INSPEKTIMET</b>	Mungesa e planifikimit të duhur të inspektimeve	Ligjet, aktet nënligjore;	4	9	36	Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtoria e Inspektionit	Çdo fundvit
		Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve	re; aktet e brendshme të komunës	7	10	70	Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët	Drejtoria e Inspektionit, Njësia e Burimeve Njerëzore	Çdo vit
		Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve	s	8	10	80	Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja	Drejtoria e Inspektionit, Njësia e Burimeve Njerëzore	Implementohe t brenda 1 viti
		Mungesa e kontrolleve mbi operatorët ekonomikë	Ligjet, aktet nënligjore; re; aktet e brendshme të komunës	7	8	56	Fuqizimi i sistemit të kontrolleve mbi funksionimin e operatorëve të biznesit. Të rriten gjohat për operatorët pa regjistrim dhe licenca valide të biznesit	Drejtoria e Inspektionit	Në vazhdimësi
		Mungesa e transparencës për punën e njësisë së inspektimit	Ligjet, aktet nënligjore; re; aktet e brendshme të komunës	5	9	45	Duhet që në Drejtorinë e Inspektionit të publikohet në baza vjetore, lista e bizneseve të inspektuara dhe shpeshësia e inspektimeve	Drejtoria e Inspektionit dhe Zyra për Informim	Fund të vitit

7.	<b>ARSIMI PUBLIK</b>	Planifikimi joadekuat dhe i paefektshëm i shërbimeve arsimore	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	4	9	36	Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes së numrit të nxënësve.	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit	Çdo fundvit
		Inspektive të pamjaftueshme të procesit mësimor		6	8	48	Të hartohet plani i inspektiveve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij	Drejtoria e Arsimit	Çdo fundvit
		Rekrutimi jo efikas i stafit në sektorin e edukimit		5	9	45	Rekrutimi i stafit të duhur arsimor, kujdesi i veçantë në marrjen e stafit për zonat ku ka nevojë urgjente. Rishikimi i procedurave operationale për rekrutimin e stafit në sektorin e edukimit për të siguruar kontrole adekuate të integritetit, p.sh. përfshirja e OJQ-ve, aktorëve të tjerë të jashtëm në panelet intervistuese, dhe rritja e transparencës së procesit të intervistimit, rritja e publicitetit të rezultateve të përzgjedhjes.	Drejtoria e Arsimit	Në vazhdimësi





	<p><b>9. SHËRBIMET PUBLIKE DHE LICENCIMI I TYRE</b></p>	<p>Efikasiteti, efektiviteti, cilësia e transparencës jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike. Menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në menaxhimin e mbeturinave</p>	<p>me të komunës</p>	<p>6</p>	<p>48</p>	<p>Të zhvillohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike.</p> <p>Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike .</p> <p>Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër</p> <p>Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave, punëtorive</p>	<p>Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe licencimin e tyre</p> <p>Drejtoria për Administratë dhe njësia e TIK-ut</p> <p>Mbikëqyrësi i shërbimeve publike</p> <p>Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike dhe Njësia e Burimeve</p>	<p>12- muaj</p> <p>12- muaj</p> <p>Në vazhdimësi</p>
--	---	--	----------------------	----------	-----------	---	--	--



1 0	KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT	Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	5	9	45	Të rritet transparencja dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt- rregulloreve në ueb faqe, inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj.)	Kryetari i Komunës, Drejtoria përkatëse dhe Zyra e Informimit	Në vazhdimësi
		Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti- korrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve		8	8	64	Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti- korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij.		

1	<b>DREJTORIA PËR PRONË, GJODEZI DHE KADASTËR</b>	Mungesa e transparencës për përdorimin e dokumenteve	Ekziston programi i AKK dhe manuale , ku bëhet regjistri mi ndërrim eve kadastra le si dhe krijohet historiat i punës.	4	8	32	Rritja e përdorimit të e-shërbimit dhe monitorimi elektronik i dokumenteve, të rritet transparencja	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Në vazhdimësi
1		Mungesa e kapaciteteve brenda njësisë kadastrale	Ligjet, aktet nënligjor e; aktet e brendshme të komunës	5	8	40	Rritja e zhvillimit profesional të stafit sipas nevojës. Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose kornizat për matje kadastrale. Licencimi i KP për gjeodezi e lehtëson punën e matjes në terren	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Zyra e Personelit	Çdo vit

**2 DREJTORIA PËR  
KULTURË, RINI  
DHE SPORT**

OJQ-të dhe organizatat sportive nuk zgjidhen rregullisht	Ligjet, aktet nënligjor e; aktet e brendshme të komunë	5	9	45	Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Në vazhdimësi
Korniza strategjike për kulturë, rini dhe sport nuk ekziston	Ligjet, aktet nënligjor e; aktet e brendshme të komunës	6	8	48	Përmirësimi i kornizës strategjike për Kulturë, Rini dhe Sport duke hartuar Planin e Veprimit komunal për Rini, Kulturë dhe Sport. Të gjitha aktivitetet kulturore sportive dhe rinore, të planifikohen me buxhet për çdo vit nga DKRSM-ja	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Implementohe t brenda vitit 2025
Mungesa e kapaciteteve profesionale e punëdhënësve sportivë	Ligjet, aktet nënligjor e; aktet e brendshme të komunës	7	8	56	Krijimi i një programi specifik për forcimin e kapaciteteve për punëdhënësit sportiv, si dhe për personat përgjegjës për menaxhimin e zonave sportive. Të sigurohet se menaxhimi i integritetit të bëhet pjesë e saj. DKRS, siguron mjetet financiare nga kategoria e subvencioneve për klube sportive OJQ dhe nga aspekti infrastrukturor me objekte dhe hapësira për zhvillim të	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	6-muaj




Kontrolli jo efikas mbi  
zbatimin e shërbimeve  
të zhvillimit të  
përdorimit të tokave

7	8	56	Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe rreth burimeve alternative të ngrohjes	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Në vazhdimësi
7	9	63	Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës		Çdo fund të vitit



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0042394/24, të datës 01.07.2024, merr:

### **V E N D I M** **PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

#### **Neni 1**

ne vendbanim në fshatin Lladoc, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të djalit saj Anuar Behrami dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 300.00€.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë përkatëse.*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj. Majlinda Behrami (njoftohet përmes DSHMS-së).*

**Nr.prot** 02-400/01-0070667/24  
**Podujevë, datë,** 28.10.2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0070295/24, të datës 24.10.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

znj. **C** nga fshati Llapashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 200.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorive përkatëse.*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj. Gentiana Kamerolli (njoftohet përmes DSHMS-së).*

Nr.prot 02-400/04-0070687/24  
Podujevë, datë, 28.10.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 17 paragrafi 1.12, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.15-300/01-0069626, të datës 21.10.2024, të proceduar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik nr.prot.02-400/04-0070661/24, të datës 28.10.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

[REDAKTUAR] nga fshati Llapashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës, për zhvillimin e biznesit të saj për blerjen e një makine për përpunimin e lëngjeve natyrale përkrahet me mjete financiare në shumë 2000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorive përkatëse.*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj. Aferdita Murati (njoftohet përmes DPZHE-së).*

Nr. prot. 02-400/01-0070923/24  
Podujevë, datë, 28.10.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Buliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-400/04-0071011/24, të datës 29.10.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Safet Blakçori** nga fshati Letanc, Komuna e Podujevës, për organizimin e Festivalit Kombëtar Folklorik “Pushka e Lirisë”, në përkujtim të datëlindjes së Heroit Kombëtar Zahir Pajaziti, mbështetet me mjete financiare në shumë 4,500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e z.Safet Blakçori i cili në emër të organizatorëve obligohet të sjell raport të detajuar në Drejtorinë përkatëse lidhur me gjitha shpenzimet e këtij aktiviteti.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorive përkatëse.*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Safet Blakçori (njoftohet përmes DKRS-së).*

Nr.prot 02-400/040071267124  
Podujevë, datë, 30.10.2024





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, merr:

### **V E N D I M** **PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË** **ADMINISTRATËS**

#### **Neni 1**

**z.Shuajb Blakçori**, me kualifikim bachelor fakulteti ekonomik-Banka Financa, Kontabilitet: MSC Ekonomi e Gjellbër, Zhvillim i Qëndrueshëm Ekonomik, Energji e Ripërtrishme - South East European University, nga fshati Letanc-Komuna e Podujevës, emërohet;

#### **➤ Drejtor i Drejtorisë së Administratës**

#### **Neni 2**

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.


#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:  
Të emëruarit  
Zyrës së personelit  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-109/03-0071269/24  
Podujevë, datë: 30.10.2024





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Njesisë për të Drejtat e Njeriut – NJDNJ datë 29.10.2024 në Komunën e Podujevës, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Me rastin e shënimit të fushatës “ Tetori-Muaji i mundësive të barabarta për personat me nevoja të veçanta” , në kuadër të fushatës kundër diskriminimit për personat me nevoja të veçanta, lejohen mjete financiare në shumë 200 €.

#### **Neni 2**

Mjetet sipas nenit 1 dedikohen për kompensimin e 10 personave me nevoja të veçanta, nga 20€ për secilin, për angazhim një (1) ditor në Administratën komunale, të cilët caktohen nga OJQ Handikos - Podujevë në koordinim me NJDNJ në kuadër të Administratës komunale.

#### **Neni 3**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të OJQ-së Handikos e cila obligohet që mjetet e cekura t’ua shpërndajë personave të caktuar dhe të paraqes raport si dëshmi për shpërndarjen e tyre.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në koordinim me NJDNJ, Zyrën e Personelit dhe OJQ-në Handikos, që obligohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e këtij aktiviteti dhe ekzekutimin e kompensimit.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave  
Njesisë për të Drejtat e Njeriut  
Zyrës së Personelit  
OJQ-së Handikos  
QSHQ/Arkivit

**Nr.prot.** 02-400/01-0071591/24  
**Podujevë, datë:** 31.10.2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**